VENDIM
Nr. 529, datë 1.8.2024

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË PËRZGJEDHJES PËR TRUPËN E NIVELIT TË LARTË DREJTUES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lirimin e z. Erind Mërkuri nga detyra e anëtarit të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues dhe përfundimin e mandatit të tij 5-vjeçar përpara kohe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama